AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

" LOSHI BL "

Shoqëria me përgjëgjësi të kufizuar " Loshi BL "SHPK Qukës Shlumbin,Librazhd themelohet nga ortaku i vetëm Bajram Hajdar Loshi,banues në Qukës Librazhd.

Neni 1

Shoqëria " Loshi BL " SHPK është person juridik dhe veprimtarinë e saj e rregullon sipas aktit të themelimit,statutit dhe akteve të legjislacionit shqipter.

Neni 2

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pasaktuar mbi dhjetë vjet.

Neni 3

Qëndra e shoqërisë është në fshatin Qukës Shlumbin të rrethit Librazhd

Neni 4

Objekt i veprimtarisë private është :tregëtimi i artikujve ushqimore e industrial me shumicë e pakicë,tregëtim karburanti,import eksport si dhe parking dhe riparim autoмjetesh.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë " Loshi BL " SHPK Qukës Shkumbin Librazhd është 100.000 lekë.Kapitali është investuar nga ortaku i vetëm themelues Bajram Hajdar Loshi.

Neni 6

Personat e punësuar në këtë shoqëri kanë të drejta dhe detyrime të cilat përcaktohen në kontratën e punës dhe aktet e themelimit të shoqërisë.

Neni 7

Drejtimi i shoqërisë " Loshi BL " SHPK do të bëhet nga ortaku i vetëm Bajram Hajdar Loshi,i cili do të jetë administrator i shoqërisë

Neni 8

Mosmarveshjet me persona juridike e fizikë,vendas e të huaj zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Tiranë,më

Themeluesi

Bajram Hajdar Loshi

# S T A T U T

# I

## SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## " LOSHI BL "

## K R E U I

## DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

### Neni 1

Shoqëria " Loshi BL " SHPK Qukës Shkumbin, Librazhd, krijohet nga orteku i vetëm z. Bajram Loshi, në bazë të kritereve të caktuara në Ligjin Nr.7512 datë 10.8.1991, Ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992.

### Neni 2

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj private në bazë të ekonomi së së tregut të lirë.

### Neni 3

Orteku i vetëm themelues ka derdhur në këtë sipërmarje kapitalin e tij, me qëllim që të përfitojë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private si dhe të përballojë humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit në kapitalin fillestar.

### Neni 4

Shoqëria " Loshi BL " SHPK Qukës Shkumbin Librazhd është person juridik dhe fiton zotësinë për të vepruar me rregjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë

## EMRI QËNDRA, TERITORI

### Neni 5

Emërtimi i shoqërisë do të jetë Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " Loshi BL "

### Neni 6

Qëndra e Shoqërisë është në fshatin Qukës, Shkumbin Librazhd por nuk përjashtohet mundësia e krijimit të degëve, agjensive dhe përfaqësive. Shoqëria mund të zhvillojë aktivitetin e saj në Qukës Librazhd dhe sipas nevojave edhe në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

SHQIPËRISË DREJTËSISË RRETHIT

## O B J E K T I

### Neni 7

Objekti i veprimtarisë dhe aktivitetit të kësaj shoqërie do të jetë:Tregëtimi i artikujve ushqimore e industriale me shumicë dhe pakicë, tregëtia karburanti,import eksport si dhe parking dhe riparim autonjetesh.

### AFATI I VEPRIMTARISË

### Neni 8

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë private për një periudhë të pacaktuar mbi dhjetë vjeçë.

### KAPITALI I SHOQËRISË

### Neni 9

Kapitali themeltar i Shoqërisë " Loshi BL" SHPK përbëhet nga kontributi fillestar i themeluesit të shoqërisë në vleftën prej 100.000 lekë,sipas aktit të themelimit të shoqërisë.Kapitali mund të rritet me zhvillimin e shoqërisë veprimtarisë ekonomike e financiare të shoqërisë.

### Neni 10

Trasferimet e kapitalit themeltar duhet të vertetohen me akt noterial.Pjeset e kapitalit themeltar janë të trasferushme në rrugë trashëgimie.Ato mund tu kalojnë bashkëshortëve,paraardhëseve dhe pasardhësve.

### Neni 11

Pjesët e kapitalit mund të trasferohen edhe në persona të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri.Në rast të shtimit të numrit të ortakëve bëhet me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën 3 /4 të pjesëve të kapitalit themeltar. Me shtimin e numrit të ortakëve,me përveshj pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të trasferushme ndërmjet tyre.

### DREJTIMI ADMINISTRATIV

### Neni 12

Shoqëria " Loshi BL "SHPK Qukës Shkumbin Librazhd do të ketë si administrator z.Bajram Loshi.Shoqëruesi i shoqërisë ka në kopetencë të caktojë administrator edhe persona të tjerë të cilët nuk kanë cilësinë e ortakut.

Neni 13

Administratori ka për detyrë organizimin dhe drejtimin e shoqëri së,i cili mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë

Neni 14

Në mardhënie me të tretët administratori angazhon shoqërinë nëpër mjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.Në rastet kur admini stratori është e emëruar nga themeluesi i shoqërisë,kryen të gjitha ve-primet e administrimit të shoqërisë,me përjashtim të atyre që janë në kompetencë të themeluesit të shoqërisë.

Neni 15

Ortaku i vetëm themelues ka në kompetencë :

- Të miratojë programin e shoqërisë;të hartojë raportin e administri mit,inventaret,llogaritë vjetore,të cilat hartohen brenda një afati 6 mujor,duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.
- Vendosën për shpërbërien e shoqërisë
- Vendos për ndarjen e fitimeve dhe mbulimin e humbjeve
- Rregullon mardhëniet e punësimit e të shpërblimit brenda shoqërisë
- Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shtetërore, personave juridik vendas e të huaj.

Neni 16

Në rast se administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator i zgjedhur posaçërisht nga ortaku i vetëm themelues,ky i fundit miraton aktet e administrimit brenda afateve të mësipërme dhe ka të drejtë të informohet për veprimtarinë e shoqërisë si dhe të njihet me llogaritë dh dhe dokumentat e shoqërisë

Neni 17

Administratori humbet detyrën e ngarkuar në rast të prishjes së shoqërisë ose kur shkarkohet nga ortaku themelues i shoqërisë.Në rast se shkarkimi bëhet pa të drejtë ai ka shkak për dëm shpërblim financiar.Në rastin e shkarkimit nga ana e ortakut themelues,përpilohet një akt me shkrim për shkarkimin e administratorit

K R E U II

MARDHËNIET EKONOMIKE FINANCIARE

Neni 18

Shoqëria " Loshi BI" SHPK mund të lidhë kontakte me sektorët shtetërore,drejtëpërdrejtë me tregun e lirë si dhe me persona juridik

e fizik vendas e të huaj sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 19

Në veprimet kontraktuale shoqëria përfaqësohet nga z.Bajram Lozhi, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij.

Neni 20

Të drejtat dhe detyrimet që rjedhin nga kontratat janë të detyru shme për shoqërinë dhe punonjësit e saj.

Neni 21

Sipas rregullave të caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve të tjera ligjore,shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal,afatet e derdhjes së tij,detyrimet ndaj shtetit,sigurimet shoqërore etj.Siaps ligjeve të tatimit mbi fitimin përcaktohet tatimet për veprimtarinë tregëtare të shoqërisë.

Shoqëria ka të drejtë të cele llogari likuiduse pranë bankave të vendit,të huaja në Shqipëri dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpër mjet tyre.

Neni 22

Për sigurimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria ka të drejtë të vetfinancohet me lëkë ose valutë të huaj.

Neni 23

Shkëmbimin e monedhës shqiptare me moneshe të huaj dhe anasjelltas mund ta bëje në përputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose me tregun e lirë privat të valutes.

Neni 24

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas cmimeve që cakton vetë shoqëria.Cmimet dhe tarifat do të caktohen sipas kërkesës dhe ofertes.

Neni 25

Shoqëria ka të drejtë të trasferojë jashtë shtetit kapitalin dhe pjesën e saj të fimit në valutë.Për pjesën e fitimit që trasferohet jashtë shoqëria paguan një tatim të shumës së fitimit që trasferohet.

Neni 26

Për pasqyrimin e aktivitetit administratori ose persona të tjerë të caktuar nga ortaku themelues ,janë të detyruar të mbajnë dokumentacionin e rregullt financiar dhe rregjistrat përkatës,sipas ligjit të vecantë.

## Neni 27

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Administratori është i detyruar të paraqesë bilancet periodike, bilance vjetore së bashku me deklaratën e fitimeve dhe humbjeve dhe ti depozitojë ato në organet financiar të juridiksionit përkatës ,ku ushtron aktivitetin shoqëria.

# K R E U III

## MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

## Neni 28

Themeluesi i shoqërisë vendos për shtimin ose pakësimin e numrit të ortakëve dhe personave të tjerë që do të punësohen në veprimtarinë e shoqërisë " Loshi BL " SHPK

## Neni 29

Marrdhëniet e punësimit brenda shoqërisë rregullohen sipas kontratës që lidhet lirisht midis palëve. Kontrata lëshohet nga administratori i shoqërisë pasi të jetë marrë më parë pëlqimi i themeluesit të shoqërisë ose nga ortaku që kryen detyrën e administratorit.

## Neni 30

Marrja në punë nga punëdhënësi bëhet me rregjistrimin e punonjësve në librin e punës së shoqërisë, si dhe duke u njoftuar organet e punës të juridiksionit ku ushtron aktivitetin shoqëria. ~~Vendosja e ligjere [illegible] nga shoqëria [illegible] përkatëse nga organet [illegible]~~

## Neni 31

Ortaku i vetëm themelues ,ortakët në rast se shtohet numri i tyre, administratori dhe punonjësit e tjerë të shoqërisë, janë të detyruar të respektojnë disiplinën e punës dhe mbajnë përgjegjësi për thyerjen e saj

## Neni 32

Ndaj personave që dëmtojnë pronën e shoqërisë zbatohen masa ndëshkimore të cilat përcaktohen nga themeluesi i shoqërisë dhe në mungesën e tij zbatohen dispozitat e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

## Neni 33

Kontratat e punës mund të lidhen me ose pa afat të caktuar

sipas kritereve të caktuara nga ortaku i vetëm themelues,ose nga ortakët kur shtohet numri i tyre dhe në mungese të parashikimeve në kontratë sipas ligjeve në fuqi.

Neni 34

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga ortaku themelues dhe administrator z.Bajram Loshi. Largimi lidhet me zbarimin e kontratës së punës,për shkak të shkeljeve disiplinore ose me vetë kërkesën e të interesuarit.

Neni 35

Punonjësit gëzojnë të drejtat sipas kritereve të përcaktuara në kontratën e punës e në mungesë të tyre sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 36

Punonjësi që largohet ose transferohet në një punë tjetër duhet të bëjë dorëzimin e detyrës në bazë të një akti me shkrim,pasi të ketë likuiduar detyrimet materiale dhe monetare.Akti i mësipërm mbahet nga administratori i shoqërisë.

ELEMENTË TË TJERA

Neni 37

Për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë ekonomike shoqëria mund të marë truall me qira. ose në pronësi.

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Neni 38

Të ardhurat neto pas shlyerjes së detyrimeve fiskale sigurimeve shoqërore etj kalojnë në pronësi të ortakut të vetëm themelues ose të ortakëve të tjerë në se ka të tillë. dhe ndahet sipas kontributit të secilit.

Neni 39

Shpërblimi për administratorin dhe personat e punësuar në veprimtarinë e shoqërisë " Loshi BI" SHPK caktohet sipas kontratës së punës. Ndryshimi në pagë vendoset nga themeluesi i shoqërisë ose nga ortakët në rast se shtohet numri i tyre.

Neni 40

Shoqëria përballon humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të saj fillestar në kapitalin bazë.

Neni 41

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur ose shtuar numrat respektive të humbjeve apo fitimeve të mbartura nga vitet e mëparëshme.

Neni 42

Ku pushon aktiviteti i shoqërisë,kapitali i mbetur,pasi shlyen detyrimet ndahet midis ortakeve sipas kontributit të secilit ose i mbetet ortakut të vetëm themelues ku nuk ka të tjerë.

Neni 43

Fitimi i mbetur kalon në pronësi të ortakut themelues,pasi janë shlyer të gjitha detyrimet tatimore si dhe pagesat e mundëshme për punonjësit e shoqërisë

## [illegible]RIA E SHOQËRISË

Neni 44

Në rast se kapitalet e shoqërisë për shkak të humbjeve të konstatuara në dokumentet financiare rezultojnë më të vogla se gjysma e kapitalit themeltar,ortaku i vetëm themelues vendos brenda katër muajve nga dita e konstatimit mbi mundësinë e prishjes së parakohëshme të shoqërisë dhe mund të kërkojë në gjykatë prishjen e saj.

Neni 45

Gjykata mund ti afrojë shoqërisë një afat maksimal prej 6 muaj për ta rregulluar gjëndjen.Ajo nuk mund ta prishë shoqërinë në rast se ky rregullim është bërë në ditën në të cilën ajo mblidhet për të marë vendim.

Neni 46

Në rast se shoqëria nuk prishet,detyrohet të zvogëlojë kapitalin e saj në një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që ka mbetur pa u mbuluar,duke marë parasysh që shuma e kapitalit të mbetur të jetë mbi 100.000 lekë.

## DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 47

Ortaku i vetëm themelues ,në rastin e shtimit të ortakëve ka të drejtë të bëjë ndryshime të nevojëshme në statut si dhe të hartojë edhe kontratën e përbashkët me ortakët e tjerë,duke bërë ndryshimet e nevojëshme në rregjistrin themeltar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

### Neni 48

Marveshjet e shoqërisë në mardhënie me prsonat juridik e fizik vendas e të huaj,zgjidhen me mirëkuptim,në të kundërt kur kjo nuk harlet zgjidhet nga Gjykata e rrethit Tiranë.Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet ligjit Nr.6512 datë 10.8.1991,dhe ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992

### Neni 49

Statuti përpilohet në disa kopje për tu dorëzuar në organet kompetente.Një kopje e tij mbetet si pjesë e dokumentacionit të formimit të shoqërisë " Loshi BL" me Përgjegjësi të kufizuar.

U nënshkrua në Tiranë, sot më datë 1994

ORTAKU I VETËM
Bajram Hajdar Loshi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA TIRANË
Nr. 701 Rep.
Nr. 153 Kol.

## VERTETIM

Sot më datë 6.4. 1994(nëntëdhjetë e katër),në zyrën e Noterisë në Tiranë,para meje noteres Lidia Kolushta u,paraqit personalisht Bajram Hajdar Loshi,madhorë,me zotësi të plotë juridike për të vepruar,për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi i tij personal,i cili deklaroi se sa më sipër statuti dhe akti i themelimit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar " Loshi BL " e përpiluar jashtë kësaj zyre,është bërë më vullnetin e lirë e të plotë të tij dhe sipas ligjit ... prej tij para meje noteres.

NOTERE
Lidia Kolushta